



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 11, 12 par.12.2 shkronja c), 16 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 32 par.5 të Ligjit Nr.04/L-179 për Transportin rrugor, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.21 e datës 13.06.2013 si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 30. 10. 2019, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TRANSPORTIN
E UDHËTARËVE ME AUTOMJETE TAKSI 15NR.011-29428 E DATËS 02.05.2019

Neni 1

1.Qëllimi i miratimit të kësaj Rregulloreje është ndryshimi dhe plotësimi i nenit 5 paragrafi 1.5, nenit 6 paragrafi 1 dhe nenit 12 paragrafi 1.1 të Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr.011-29428 të datës 02.05.2019 (në vazhdim të tekstit Rregullorja).

2. Neni 5 paragrafi 1.5 i Rregullores riformulohet si vijon:

Ngjyra e automjeteve taksi mund të jenë të ndryshme me kusht që automjetit t'i vendoset një shirit identifikues me ngjyrë bardhë e zi, sipas standardeve duke përjashtuar automjetet taksi që operojnë në aeroportin ndërkombëtar "Adem Jashari" të cilat duhet të jenë të ngjyrosura vetëm me ngjyrën e bardhë.

3.Neni 6 paragrafi 1 i Rregullores riformulohet si vijon:

Kryetari i Komunës merr Vendim për shpalljen e Njoftimit publik për dhënien e licencave dhe formon Komisionin për shqyrtimin e aplikacioneve të operatorëve dhe verifikimin e automjeteve. Komisioni do të jetë në përbërje prej 5 anëtarëve.

4.Neni 12 paragrafi 1.1 i Rregullores, riformulohet si vijon:

1.1 Operatorët të cilët operojnë në qytetin e Lipjanit të kenë të ngjyrosur automjetin me cilën do ngjyrë të përzgjedhur nga operatori me kusht që

automjetit t'i vendoset një shirit identifikues me ngjyrë bardhë e zi sipas standardeve, ndërsa operatorët të cilët operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" të kenë të ngjyrosur automjetin me ngjyrë të bardhë, të regjistruar, teknikisht në gjendje të rregulltë si dhe pa dëmtime në pjesën e jashtme dhe të brendëshme të automjetit.

Neni 2

1. Kjo Rregullore hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Nr.15- 345-70953

Lipjan, më 31. 10. 2019

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

